



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 maj 2021
Nr. ref.:RK 1792/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI22/21

Parashtrues

Hasime Daka

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA.nr. 5/2021, i 29 janarit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hasime Daka nga Suhareka (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AA. nr. 5/2021, të 29 janarit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 shkurt 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 2 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 3 shkurt 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që, në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, të qartësojë nëse kërkesën e ka dorëzuar si kërkesë individuale, apo e përfaqëson edhe subjektin politik NISMA Socialdemokrate (në tekstin në vijim: NISMA).
8. Më 9 shkurt 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë një autorizim i cili nuk ofroi sqarimet shtesë të kërkuara nga Gjykata.
9. Më 11 shkurt 2021, Gjykata përsëriti kërkesën për sqarim duke kërkuar nga parashtruesja e kërkesës që të sqaroj/plotësoj pikat vijuese përkitazi me çështjen e autorizimit: (i) cili është autoriteti apo personi në subjektin politik NISMA i cili e autorizon që të paraqes kërkesë në Gjykatën Kushtetuese në emër të subjektin politik NISMA; (ii) cili është fushëveprimi i autorizimit, respektivisht a autorizoheni që ta përfaqësoni subjektin politik NISMA, apo jo; (iii) autorizimi duhet të përmbajë edhe nënshkrimin e autoritetit brenda subjektit politik NISMA.
10. Brenda afatit të përcaktuar, parashtruesja e kërkesës nuk dorëzoi sqarimet e kërkuara në Gjykatë.

11. Më 2 mars 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
12. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesja e kërkesës më 20 shkurt 2018, përmes Aktgjykimit [P.nr.2080/16] të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) ishte shpallur fajtores për kryerjen e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 të nenit 378 (Rrezikimi i trafikut publik) të Kodit Penal Nr. 04/L-082 (në tekstin në vijim: Kodi Penal). Gjithashtu, vlen të theksohet se parashtruesja e kërkesës kishte arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Prizren, me ç'rast ishte dënuar me kusht, ashtu që i vërtetohej dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohej në afatin kohor prej dy (2) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, me kushtin që parashtruesja e kërkesës nuk do të kryen ndonjë vepër të re penale.
14. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton që në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet e parakohshme të mbajtura më 14 shkurt 2021, lidhur me procesin e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të saj, NISMA, më 16 janar 2021 dorëzoi në KQZ dokumentacionin për certifikim të subjektit politik dhe kandidatëve të saj.
15. Më 20 janar 2021, Zyra për certifikimin e partive politike (në tekstin në vijim: Zyra) njoftoi NISMA-n se 12 kandidatë (përfshirë edhe parashtruesen e kërkesës) nuk janë në përputhje me nënparagrafin q të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme; si dhe kërkoi zëvendësimin e këtyre kandidatëve me kandidatë të gjinisë së njëjtë deri më 21 janar në ora 13:00.
16. Më 22 janar 2021, përderisa NISMA nuk kishte sjellë plotësimet e kërkuara, në mbledhjen e saj, KQZ me shumicë votash përmes Vendimit [242-2021] nuk e certifikoi subjektin politik NISMA dhe as listën e kandidatëve të saj.
17. Më 22 janar 2021, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [Pk.nr.53/21] aprovoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës në cilësi të të dënuarës, për shlyerje të dënimit me kusht nga evidenca e të dënuarve (shih më lart Aktgjykimin [P.nr.2080/2016] të 20 shkurtit 2018, të Gjykatës Themelore i cili ishte bërë i plotfuqishëm me 12 qershor 2018).
18. Më 23 janar 2021, NISMA, në cilësi të subjektit politik dhe rrjedhimisht personit juridik, paraqiti apel në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejme: PZAP), kundër vendimit të KQZ-së [242-2021] të 22 janarit 2021. Në apel, NISMA theksoi se KQZ-ja nuk e ka certifikuar listën e 110 kandidatëve të NISMA-s, si dhe subjektin politik, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, me ç'rast ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Përfundimisht, NISMA propozoi që PZAP të anulojë Vendimin e KQZ-së, si dhe të aprovojë apelin e tyre duke certifikuar subjektin politik NISMA dhe 110 kandidatët e listës së saj.

19. Më 25 janar 2021, PZAP përmes Vendimit [Anr.16/2021], PZAP: (i) refuzoi pjesërisht apelin e subjektit politik NISMA, ndërsa vërtetoi Vendimin e KQZ-së [242-2021] të 22 janarit 2021, në pjesën e refuzimit të rekomandimit të Zyres për certifikimin e kandidatëve për deputetë të subjektit politik NISMA dhe atë: V.K, B.B, F.B, V.A, Xh.B, A.Th, M.F, Hasime Daka, F.G, V.A, E.Sh, A.N; (ii) pranoi pjesërisht apelin e subjektit politik NISMA; (iii) ndryshoi Vendimi i KQZ-së [242-2021] i 22 janarit 2021, dhe vendosi që të pranohet pjesërisht rekomandimi i ZRPPC-së, certifikohet subjekti politik NISMA dhe lista e kandidatëve për deputetë të këtij subjekti politik, me përjashtim të kandidatëve të cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi; (iii) kandidatët për deputetë të cekur në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, nuk mund të zëvendësohen me kandidatë të tjerë.
20. Në një datë të pacaktuar, NISMA, në cilësi të subjektit politik dhe rrjedhimisht personit juridik, paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër Vendimit të lartcekur të PZAP-it. Me atë rast, NISMA kontestoi ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it duke pretenduar konstatimit të gabuar dhe jo të saktë të gjendjes faktike si dhe kundërshtim ndaj masave ndëshkuese kundër NISMA-s në të reflektuara në pikën III të dispozitivit që kishte të bëjë me moslejimin e plotësimit të listës me kandidatë tjerë. NISMA i propozoi Gjykatës Supreme që të anulojë Vendimin e PZAP-it, të aprovoj certifikimin e subjektit politik NISMA me listën e plotë prej 110 kandidatëve për zgjedhje të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, si dhe të shfuqizojë pikën III të vendimit të PZAP-së.
21. Në një datë të pacaktuar, PZAP paraqiti përgjigje në ankesën e NISMA-s, duke kundërshtuar thëniet ankimore dhe duke propozuar që ankesa e subjektit politik NISMA të refuzohet si e pabazuar.
22. Më 29 janar 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [AA.nr.5/2021] e refuzoi si të pabazuar ankesën e NISMA-s, të paraqitur kundër vendimit të PZAP [A.nr.16/2021] të 25 janarit 2021.
23. Gjykata Supreme e arsyetoi Aktgjykimin e saj si në vijim:

“Ligji Nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës me dispozitat e nenit 29 ka përcaktuar Përshtatshmërinë/Aftësia e Kandidatit për certifikim, në atë mënyrë në paragrafin 1, përcaktohet se: “Cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai apo ajo është”, ndërsa në pikën q) të nenit të njëjtë përcaktohet se: “i shpallur fajtor për veprë penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit”. Nga interpretimi i dispozitës se cituar rezulton se në këtë rast LZP, e parasheh si pengës për tu certifikuar një kandidat me vet faktin se i njëjti është shpallur fajtor për veprë penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit. Dispozita në fjalë nuk e ka bërë klasifikim të veprave penale të cilat do të ishin pengës për tu certifikuar, apo të veprave që nuk kategorizohen

si vepra që e pengojnë kandidatin për tu certifikuar e as të dënimeve sipas llojit.”

Gjykata Supreme e Kosovës në rastin konkret mori në shqyrtim edhe pretendimet ankimore të subjektit zgjedhor NISMA Socialdemokrate në veçanti lidhur me kandidatet Hasime Daka, [...] dhe në fazën e ankesës ka paraqitur Aktvendimin për shlyerjen nga evidenca e të dënuarve, Pk.nr.53/21 të datës 22 janar 2021 i formës së prerë me 26 janar 2021. [...] Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Gjykata Supreme i trajtoi si evidencë të pranuar në fazën e procedurës me ankesë dhe në kuptim të nenit 180.1 të LPK-së, ku parashihet se palët në ankesë nuk mund të paraqesin fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë, përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e fazës së verifikimit. Pra këto prova nuk janë paraqitur në fazën e shqyrtimit të dhe verifikimit të përshtatshmërisë së kandidatëve pranë zyrës përkatëse, KQZ-së apo PZAP-së për shkak se këto vendime për shlyerjen e dënimeve, janë bërë të plotfuqishme më 26 janar 2021 përkatësisht më 28 janar 2021. Gjykata Supreme vlerëson se kjo evidencë nuk paraqet relevancë sepse dëshmia e rehabilitimit është paraqitur pasi është vlerësuar përshtatshmëria. Po ashtu është vërtetuar se këta dy kandidat sikur edhe të tjerët që janë përfshirë në listën e atyre që ju refuzohet certifikimi, sipas nenit 29 par.1 pika 4) i LZP-së, nuk e kanë kaluar afatin trevjeçar duke u mbështetur edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO95/2020 i datës 06.01.2021, i cili nuk i referohet dispozitave të Kodit Penal të Kosovës por vetëm dispozitës përkatëse të LZP-së nuk mund të jenë në listë.”

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se përmes Aktvendimit të kontestuar i janë shkëlur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.
25. Parashtruesja e kërkesës pretendon që asaj i është mohuar një e drejtë elementare dhe themelore e garantuar me Kushtetutë, përkatësisht përmes nenit 45 të saj. Parashtruesja e kërkesës thekson se një e drejtë e tillë e të drejtës për tu zgjedhur nuk iu ka kufizuar me Aktgjykim si masë plotësuese por Aktgjykimi i saj është marrë si i përgjithësuar, dhe tani vlen të ceket se e njëjta nuk ka kryer kurrfarë krimi apo vepër penale kundër shtetit, sigurisë juridike, apo korrupsionit, por e njëjta ka pasur një aksident të rastësishëm i cili është kryer pa dashjen e saj dhe për të njëjtën është penduar thellësisht e mu për atë edhe Gjykata Themelore kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i ishte shqiptuar dënimi me kusht. Në vijim parashtruesja e kërkesës thekson se lidhur me këtë dënim Gjykata që kishte shqiptuar dënimin, përkatësisht Gjykata Themelore kishte marrë Aktvendim mbi shlyerjen nga evidenca e të dënuarve për këtë vepër penale, andaj me Kodin Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082, sipas nenit 104 (Rehabilitimi gjyqësor) personi i tillë nuk konsiderohet i dënuar.
26. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se i është cenuar e drejta e barazisë gjinore për pjesëmarrje në Kuvend, sepse kuota gjinore prej 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar nuk po respektohet dhe kjo do të jetë e rrezikshme për demokracinë dhe shtetin parlamentar.

27. Në vijim, parashtruesja e kërkesës konsideron se i është bërë e padrejtë për faktin se me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme parashihet se person i dënuar tri vitet e fundit nuk mund të aplikojë për deputet, ligj ky i cili sipas pretendimeve të saj është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Kodin Penal të cekur më lart me të cilin personi i fshirë nga evidenca e të dënuarve nuk konsiderohet i dënuar, andaj e njëjta konsideron se Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme është diskriminues dhe si i tillë nuk do të duhej të aplikohet në rastin konkret.
28. Parashtruesja në vijim thekson se fakti se lista e subjektit politik NISMA nuk është shqyrtuar për secilin kandidat veç e veç por është shqyrtuar si tërësi, ndërkaq tek partitë tjera si Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës janë trajtuar të gjithë kandidatët një nga një dhe me këtë rast të dënuarit njëjtë si ankuesja (parashtruesja e kërkesës) për veprën penale të komunikacionit iu është lejuar e drejta e pjesëmarrjes në garën për deputetë përkundër asaj që parashtruesja është femër dhe me eliminimin e saj nga e drejta për të kandiduar do të çrregullohej kuota gjinore e garantuar me Kushtetutë.
29. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës propozon që kërkesa e saj të aprovohet si e bazuar.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

- 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.*

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Kodi Penal i Kosovës Nr. 04/L-082

Neni 378 Rrezikimi i trafikut publik

1. Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që shkel cilindo ligj mbi trafikun rrugor apo transportin rrugor dhe me këtë rrezikon trafikun hekurudhor, me tramvaj, me trolejbus, me autobus, me teleferik ose trafikun ujor dhe në këtë mënyrë rrezikon jetën e njerëzve, sigurinë fizike ose pasurinë, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

[...]

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

7. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

8. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

[...]

Kodi Penal i Kosovës Nr. 06/L-074

Neni 97 Rehabilitimi gjyqësor

Gjykata, me kërkesën e personit të dënuar, mund të vendosë që dënimi t'i shlyhet nga evidenca e personit të dënuar dhe ai person konsiderohet i padënuar nëse ka kaluar gjysma e afatit përkatës të paraparë me

paragrafin 2. të nenit 96 të këtij Kodi dhe nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe nuk ka kryer veprë të re penale. Me rastin e vendosjes për shlyerjen e dënimit të parashkruar ose përfunduar me falje ose me ndryshim të Kodit Penal, gjykata merr parasysh sjelljen e personit të dënuar pas mbajtjes së dënimit, natyrën e veprës penale dhe rrethanat e tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e përshtatshmërisë së shlyerjes së dënimit.

Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të ndryshuar sipas Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

**Neni 118
[Vendimet]**

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet. [...]

118.4 Mund të apelohe vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej 72 (shtatëdhjetë) orëve pas paraqitjes së apelit.

**Neni 119
[Ankesat]**

119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa [...].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti specifikisht i referohet nenit 22, paragrafit (4) të Ligjit, që përcakton:

"Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të ... plotësuar kërkesën (...)".

33. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve], nënregullin (2) shkronja (h) dhe rregullin 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës], nënregullin (5) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

32 (2) "Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

Rregulli 35

(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze.

[...]

34. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse.
35. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e saj të garantuara me nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës.
36. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se kërkesa u dorëzua nga parashtruesja e kërkesës, e cila kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, [A.A. nr. 5/2021] të 29 janarit 2021. Ky i fundit ishte nxjerrë nga Gjykata Supreme pas ankesës që NISMA, në cilësinë e subjektit politik dhe rrjedhimisht në cilësinë e personit juridik, ka parashtruar kundër Vendimit [A.nr. 16/2021] të PZAP-it, të 25 janarit 2021.
37. Gjykata gjithashtu rikujton që pas regjistrimit të kërkesës, më 3 shkurt 2021, ka kërkuar nga parashtruesja e kërkesës që të paraqet sqarime lidhur me atë se a e

ka dorëzuar kërkesën vetëm në cilësi individuale apo edhe si përfaqësuese e subjektit politik NISMA.

38. Pas kërkesës së parë të Gjykatës për sqarime, parashtruesja e kërkesës kishte sjellë një autorizim të përgjithshëm për përfaqësim të subjektit politik NISMA, e cila në vlerësimin e Gjykatës nuk ishte i qartë, i mungonte emri i autoritetit që kishte lëshuar autorizimin si dhe nuk definonte fushëveprimin e autorizimit. Parashtruesja e kërkesës nuk dorëzoi sqarimet e kërkuara as pas kërkesës së dytë të Gjykatës të 11 shkurtit 2021, ku specifikisht kërkohej që: (i) autorizimi duhet të përmbajë të dhënat e autoritetit në subjektin politik NISMA i cili jep autorizimin për përfaqësim në Gjykatë Kushtetuese; (ii) autorizimi duhet të përcaktoj fushëveprimin e tij, respektivisht se a autorizohet parashtruesja që ta përfaqësojë subjektin politik NISMA; (iii) nënshkrimin e autoritetit brenda subjektit politik NISMA.
39. Pra, Gjykata i është drejtuar parashtrueses së kërkesës dy herë me një kërkesë të tillë, mirëpo edhe pse më 9 shkurt 2021, parashtruesja e kërkesës kishte dorëzuar një autorizim i cili nuk ofronte sqarimet shtesë të kërkuara nga Gjykata, ndërsa në kërkesën e dytë të Gjykatës drejtuar parashtrueses së kërkesës për qartësim të fushëveprimit të autorizimit të dorëzuar, e njëjta nuk ishte përgjigjur fare në këtë kërkesë specifike të Gjykatës.
40. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI 60/20, parashtrues: *Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame*, Vendim për refuzim i 18 shkurtit 2021, paragrafi 36; KI90/20, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25; dhe rastet nr. KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).
41. Në rrethana kur një kërkesë para Gjykatës është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të saj ndaj parashtrueses së kërkesës që të plotësojë apo qartësojë kërkesën, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
42. Andaj, Gjykata, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 22.4, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullat 32 (2)(h), 35 (5) dhe 59 (3) të Rregullores së punës, më 5 maj 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi